

Ju jeni në një situatë emergjente dhe ju duhet përkohësisht një shtëpi?

- **Ju duhet distancë nga përditshmëria juaj?**
- **Dëshironi të tërhiqeni, për tu riorientuar?**
- **Ju nevojitet një kulm mbi kokë?**
- **Jeni e detyruar të gjeni për juve dhe fëmijët tuaj në shtëpi të përkohshme?**

Oferta Herberge für Frauen

Ju tek ne gjeni pranim, pavarësisht nga kombësia juaj, përkatësia fetare apo nga të ardhurat tuaja.

Ne ju ofrojmë një mundësi banimi, me përcjellje, për kohë maksimale deri në 6 muaj. Ju do të keni dhomën tuaj dhe i ndani dhomat e tjera të përbashkëta me gra të tjera dhe fëmijët e tyre.

Ju keni kohë të qartësoheni mbi perspektivat tuaja për të ardhmën. Gra eksperte ju informojnë, këshillojnë dhe përkrahin juve gjatë hapave tuaj të mëtejshëm. Ato do t'ju ndihmojnë juve gjatë pyetjeve rreth jetës së përditshme dhe sipas nevojës do t'ju ndërmjetësojnë kontakte për këshillimoret profesionale, tek institucionet, mjekët dhe mjekët, avokatët dhe avokatët etj. Nëse ka nevojë, ne po ashtu e sqarojmë me ju financimin e vendqëndrimit tuaj në strehimore.

Ne nuk i pranojmë gratë, të cilat nuk e kanë moshën e plotë (të cilat janë të mitura), të cilat janë të varura nga alkoholi apo droga. Po ashtu edhe gra të cilat për arsye të sëmundjeve apo një hendikepi i nevojitet përkujdes i vecantë.